



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2019
Nr. ref.:RK 1491/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI57/19

Parashtrues

Slavica Mirić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit
të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për
çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0238,
të 10 janarit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Slavica Mirić, me vendbanim në Nish, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Muhamet Shala, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-19-0015-A0001, të 14 shkurtit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të lartcekura të Kolegjit të Apelit, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon moszbulimin e identitetit të saj.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 prill 2019, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 10 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 2 maj 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
9. Më 19 gusht 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dorëzimin e disa vendimeve gjyqësore dhe parashtrësive të paraqitura pranë gjykatave të rregullta.

10. Më 30 gusht 2019, parashtruesja e kërkesës i dërgoi disa nga dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
11. Më 12 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Sipas informacioneve të përfshira në kërkesë, rezulton se më 20 mars 2006, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar dy kërkesa në zyrën e BE-së në Beograd, ndaj NSH "Eximkos", duke kërkuar që t'i paguhen disa paga.
13. Më 8 maj 2007, ndërmarrja NSH "Eximkos" hyri në proces të likuidimit. Gjatë datave 8 dhe 12 qershor 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikoi lajmërimin se afati për parashtrimin e kërkesave, në lidhje me likuidimin e ndërmarrjes në fjalë, ishte deri më 13 shtator 2007.
14. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 9 tetor 2013, Autoriteti i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kishte nxjerrë dy vendime: (i) vendimin nr. PRN. 092-0028, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës për paga të papaguara për periudhën qershor 1999-qershor 2007, në shumë prej 20.000,00 €, si dhe (ii) vendimin PRN. 0092-0027, për tri paga të papaguara në shumë të paspecifikuar në NSH "Eximkos" Prishtinë.
15. Më 13 dhjetor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në DHPGJS kundër vendimeve të lartcekura të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
16. Më 29 shtator 2016, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit C-IV-13-3739, refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi vendimet e Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin se parashtruesja e kërkesës nuk i kishte parashtruar kërkesat në afatin e caktuar deri më 13 shtator 2007 sipas njoftimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM), por i kishte parashtruar shumë kohë para njoftimit të bërë nga AKM, përkatësisht më 20 mars 2006. Rrjedhimisht, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, theksoi se kërkesat e parashtrueses së kërkesës, ishin refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit si të parashtruara në mënyrë jo të rregullt.
17. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, arsyetoi se parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kërkesat jashtë afatit për parashtrimin e kërkesave, përkatësisht nuk ishin parashtruar në mënyrë të rregullt dhe me kohë. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, u mbështet në nenin 35, lidhur me nenin 7, pika 2.6.3 dhe 2.6.4, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/Lo34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të cilët përcaktojnë procedurën për njoftimin e likuidimit dhe afatet për parashtrimin e kërkesave dhe nenin 37, paragrafi 4 pika 1 të po të njëjtit ligj, sipas të cilit përcaktohet se kërkesat që konsiderohen të jenë të paafatshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi. Në këtë vendim, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së

vendosi që të miratojë kërkesën e parashtrueses së kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, për shkak të gjendjes ekonomike.

18. Më 25 tetor 2016, parashtruesja e kërkesës paraqet ankesë pranë Kolegjit të Apelit, kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar se ai është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Më 27 tetor 2016, DHPGJS i dërgoi parashtrueses së kërkesës një vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore në shumë 30 €, duke i tërhequr vërejtjen asaj se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore për procedurë ankimore brenda periudhës 15 (pesëmbëdhjetë) ditore, ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr, sipas nenit 253, paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe nenit 5.5.1 dhe 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Në këtë vërejtje parashtruesja e kërkesës ishte këshilluar se ka mundësi për paraqitjen e kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.
20. Parashtruesja e kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore, edhe pas vërejtjes në fjalë, edhe pse sipas shkresave të lëndës rezultoi se vërejtja ishte pranuar nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, më 10 nëntor 2016.
21. Më 10 janar 2019, Kolegji i Apelit nxjerr Aktvendimin AC-I-16-0238, përmes të cilit ankesën e parashtrueses së kërkesës e konsideron të tërhequr, për shkak se: (i) parashtruesja e kërkesës nuk ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar me njoftimin (vërejtjen) e 27 dhjetorit 2016; dhe (ii) nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore. Kolegji i Apelit mbështeti vendimin e tij në nenin 253, paragrafët 4 dhe 5, të LPK-së dhe nenet 3.1 dhe 2.4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore i Këshillit Gjyqësor i Kosovës.
22. Në këtë Aktvendim, Kolegji i Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se: *“Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përcaktimi i taksës gjyqësore për t’u paguar në kohën kur është paraqitur/parashtruar parashtresa është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtresës. Neni 2.4 i UA e përcakton se shprehja ‘parashtresë’ përdoret për padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, etj”*.
23. Më 28 janar 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në DHPGJS një parashtresë duke kërkuar rishikimin e Aktvendimit AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019. Në këtë parashtresë, parashtruesja argumentoi se gjykatat mund të hedhin poshtë parashtresën për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetin e goditjes, prandaj Kolegji i Apelit ka shkelur nenin 5.5.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, sepse mjet i goditjes është ankesa, dhe se në rastet e kontesteve të punës pjesëmarrësit në procedurë kontestimore janë të liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

24. Më 14 shkurt 2019, Kolegji i Apelit, përmes Aktvendimit AC-I-19-0015-A0001, e hodhi poshtë si të papranueshme parashtresën e parashtrueses së kërkesës për rishikimin e Aktvendimit AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019. Kolegji i Apelit arsyetoi si në vijim:

“[...] sipas nenit 10, paragrafi 14 i Ligjit nr. 04/L-033 mbi [DHPGJS-në], të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë përfundimtare dhe nuk janë subjekt i ndonjë ankimi të sërishëm. [...] Kolegji i Apelit vëren se në lëndën konkrete AC-I-16-0238 tashmë është vendosur nga Kolegji i Apelit me Aktvendimin e datës 10 janar 2019, i cili është i plotfuqishëm. Me këtë Aktvendim ankesa e paditëses e datës 25 tetor 2017 e paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-3797 të datës 29 shtator 2016, konsiderohet e tërhequr pasi që paditësja kishte dështuar ta paguaj taksën gjyqësore për procedurën ankimore e kërkuar me njoftimin (vërejtjen) të datës 27.10.2016 i cili njoftim ishte pranuar nga avokati i paditëses me datë 10.11.2016. Për më tepër, paditësja nuk ishte paraqitur as kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për të cilën të drejtë ai ka qenë i njoftuar me njoftimin e datës 27.10.2016”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-19-0015-A0001, të 14 shkurtit 2019, në ndërlidhje me Aktvendimin AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
26. Parashtruesja e kërkesës thekson se e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nuk është zbatuar në rastin e saj, sepse Kolegji i Apelit nuk ka shqyrtuar ankesën e saj (që ishte paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së).
27. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, të 14 shkurtit 2019, me të cilën është hedhur poshtë kërkesa e saj për rishqyrtim të Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019, është “shkelur dispozita e nenit 5.5.1 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore [...]”. Parashtruesja e kërkesës citon paragrafin e nenit 5.5.1 i cili thekson: “Nëse taksa për parashtresë nuk paguhet deri në datën përfundimtare sipas këtij neni dhe kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi për pagesën e saj, gjykata do të hedhë poshtë parashtresën me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetet e goditjes”. Parashtruesja e kërkesës thekson se mjet i goditjes është ankesa.
28. Tutje, parashtruesja e kërkesës thekson se: “Madje përveç këtij fakti vendimtar është me rëndësi të theksohet edhe fakti se, lidhur me kontestet nga marrëdhënia e punës pjesëmarrësit në procedurë kontestimore janë të liruar nga pagesa e taksës gjyqësore. Madje, edhe në bazë të Udhëzimit Administrativ i cili ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së ankesës e cila është objekt shqyrtimi, është paraparë që, në rast të mospagesës eventuale të taksës

gjqësore, gjykata obligohet që sërish ta njoftoj palën me obligimin e pagesës së taksës duke ia dërguar vërejtjen për pagesën e taksës me vlerë të shtuar”.

29. Parashtruesja e kërkesës, duke cituar nenin 53 të Kushtetutës, i referohet rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*. Duke tërhequr paralele me këtë rast, parashtruesja pretendon se në rastin e saj është shkelur parimi i barazisë së armëve me faktin se “*nuk iu është ofruar mundësia e arsyeshme për t’i shpjeguar dhe argumentuar faktet juridike dhe faktike të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi të kësaj çështje juridike kontestimore. Në këtë mënyrë, parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur as mundësi objektive që ta paraqes, shpjegoj dhe arsyetoj pikëpamjen e saj dhe [...] nuk i është mundësuar që së paku, ankesa e saj të shqyrtohet meritorisht, e mbi atë bazë të vendoset se është e bazuar ose jo*”.
30. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu thekson se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht rastit *Gusak kundër Rusisë*, GJEDNJ ka theksuar se “*ndërgjyqësi duhet të thirret në seancë gjyqësore jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore*”. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, duke cituar rastin *Fadil Selmanaj*, në të cilin Gjkata kishte konstatuar se “*parashtruesi është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për të parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës*”.
31. Në këtë vazhdë, parashtruesja e kërkesës pohon se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshin dhe të drejtën për aktgjykim të arsyetuar.
32. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjkata që të anulojë Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019.

Dispozitat përkatëse juridike

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

*Neni 253
[Përmbajtja e padisë]*

[...]

253.4 Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

253.5 Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Neni 468
[Lirimi nga pagimi i shpenzimeve]

[...]

468.3 Gjykata mund ta lirojë palën vetëm nga taksat gjyqësore po që se me pagimin e tyre do të pakësoheshin dukshëm mjetet për ushqimin e saj dhe të familjes së ngushtë të saj.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 01/2017 PËR UNIFIKIMIN E TAKSAVE GJYQËSORE

Neni 2
[Përkufizimet]

[...]

2.4 "Parashtresë" do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për përmbarim.

Neni 3
[Përcaktimi i taksave për parashtresat lidhur me kërkesat civile]

Përcaktimi i lartësisë së taksave gjyqësore që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtresës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit, gjegjësisht llojit të parashtresës, duke u bazuar në Tarifën për taksa gjyqësore të këtij Udhëzimi (TTGJ)".

Neni 5
[Mbledhja e taksave dhe pasojat e mospagesës]

[...]

5.5 Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si në vijim:

5.5.1 Nëse taksa për parashtresë nuk paguhet deri në datën përfundimtare sipas këtij neni dhe kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi për pagesën e saj, gjykata do të hedh poshtë parashtresën me përjashtim të parashtresave lidhur me mjetet e goditjes.

Neni 8
[Lirimi nga pagesa e taksave]

8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim:

8.1.1 personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla.

8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtarëve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai.

[...]

8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për t'u liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova:

8.3.1 dëshmi se ai/ajo është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

8.3.2 dëshmi se ai/ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra për Ndihmë juridike falas.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa Individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe e ka dorëzuar kërkesën e saj në afatin kohor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
37. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në thelb, pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta (gjegjesisht dy shkallëve gjyqësore të DHPGJS-së), asaj i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Lidhur me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-19-0015-A0001, të 14 shkurtit 2019

39. Gjykata vë në dukje se, edhe pse parashtruesja e kërkesës në mënyrë shprehimore konteston Aktvendimin AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019, vendimi i fundit lidhur me rastin e parashtrueses së kërkesës është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-19-0015-A0001, i 14 shkurtit 2019.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-19-0015-A0001, të 14 shkurtit 2019, parashtrueses së kërkesës i ishte hedhur poshtë kërkesa për rishikim, kundër Aktvendimit të 10 janarit 2019, me arsyetimin se kishte përdorur një mjet të palejueshëm juridik.
41. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-033 të DHPGJS-së, përcaktohet:

[...]

“14. Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

15. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet ose zbatohet për të kufizuar ose për të tentuar për të kufizuar të drejtën kushtetuese të çdo personi për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me ligjin dhe rregullat procedurale për një kërkesë të këtillë, për

shqyrtimin e kushtetutshmërisë të cilitdo vendim ose aktgjykim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme ose cilado gjykatë tjetër”.
[...]

42. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së hodhi poshtë, si të palejueshme, kërkesën për rishqyrtimin kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit (të 10 janarit 2019), duke arsyetuar se:

“Kolegji i Apelit vëren se në lëndën konkrete AC-I-16-0238 tashmë është vendosur nga Kolegji i Apelit me Aktvendimin e datës 10 janar 2019, i cili është i plotfuqishëm. Me këtë Aktvendim ankesa e paditëses e datës 25 tetor 2017 e paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-3797 të datës 29 shtator 2016, konsiderohet e tërhequr pasi që paditësja kishte dështuar ta paguaj taksën gjyqësore për procedurën ankimore e kërkuar me njoftimin (vërejtjen) të datës 27.10.2016 i cili njoftim ishte pranuar nga avokati i paditëses me datë 10.11.2016. Për më tepër, paditësja nuk kishte paraqitur as kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për të cilën të drejtë ai ka qenë i njoftuar me njoftimin e datës 27.10.2016”.

43. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, përveç kërkesës në Gjykatë Kushtetuese, Ligji për DHPGJS-në nuk mundëson asnjë mjet tjetër juridik për apelimin e vendimeve përfundimtare të Kolegjit të Apelit. Ky konstatim është konfirmuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI02/15, me parashtrues *Qendra shoqërore, kulturore, sportive dhe ekonomike “Pallati i Rinisë”*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 18 majit 2015, paragrafi 29; KI120/17, me parashtrues *Haviz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 34; KI18/17 me parashtrues *Isuf Bajrami*, Aktvendimin për papranueshmërinë, i 19 prillit 2018, paragrafi 33; KI93/18, parashtrues: *DPZ “Elektron”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2019, paragrafi 31). Në të gjitha këto raste, Gjykata theksoi:

“[...] është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese”.

44. Në dritën e kësaj, Gjykata nuk do të lëshohet në vlerësimin e mëtutjeshëm të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-19-0015-A0001, të 14 shkurtit 2019. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se “vendimi përfundimtar” (mjeti i fundit efektiv juridik), sipas kuptimit të rregullit 39 (1) (c) dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, për rastin e parashtrueses së kërkesës, është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0238, i 10 janarit 2019.

Lidhur me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019

45. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, ka të bëjë me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-16-0238, të 10 janarit 2019, me të cilin u vendos që kërkesa e saj konsiderohej e tërhequr, me arsyetimin se nuk është paguar taksa gjyqësore prej 30 € dhe nuk është paraqitur kërkesa për lirim nga pagesa nga taksa gjyqësore.

46. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës ngritë tri pretendime të ndërlidhura me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm: Së pari, parashtruesja pretendon se: (i) sipas nenit 5.5.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, gjykatat nuk mund ta hedhin poshtë mjetin e goditjes, përkatësisht ankesën në rastin e saj; dhe (ii) është e liruar nga pagesa e taksës gjyqësore sepse çështja e saj është kontest nga marrëdhënia e punës. Së dyti, parashtruesja e kërkesës pretendon se është shkelur parimi i barazisë së armëve me faktin se nuk iu është ofruar mundësia e arsyeshme për t'i shpjeguar faktet e rëndësishme të çështjes dhe se ajo është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore. Së treti, parashtruesja e kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor.
47. Përkitazi me pretendimin e parë, Gjykata fillimisht vë në dukje se çështja e pagesës së taksës gjyqësore tek parashtruesat lidhur me mjetet e goditjes pranë DHPGJS-së, është ngritur në Gjykatën Kushtetuese edhe në dy raste të tjera, përkatësisht në rastin KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 shtatorit 2018, dhe rastin KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 shkurtit 2019.
48. Në të dyja këto raste Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Është roli parësor i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës Kushtetuese KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, cituar më lart, paragrafi 36; dhe KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, cituar më lart, paragrafi 40).
49. Duke i adresuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit, me Aktvendimin AC-I-16-0238, e konsideroi ankesën e parashtrueses së kërkesës të tërhequr, për shkak se: (i) parashtruesja e kërkesës nuk ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar me njoftimin (vërejtjen) e 27 dhjetorit 2016; dhe (ii) nuk ka paraqitur ankesë për lirim nga taksa gjyqësore. Kolegji i Apelit mbështeti arsyetimin e tij në nenin 253, paragrafët 4 dhe 5 të LPK-së, si dhe nenet 2.4 dhe 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.
50. Kolegji i Apeli i sqaroi parashtrueses së kërkesës se çka nënkupton fjala “parashtruesë” dhe që përcaktimi i lartësisë së taksave gjyqësore që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtruesës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit. Për më tepër, Kolegji i Apelit i kishte sqaruar parashtrueses së kërkesës se bazuar në LPK, paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar dhe në qoftë se nuk e paguan atëherë padia konsiderohet e tërhequr.
51. Gjykata rikujton se edhe pse DHPGJS kishte dërguar një vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 30 € tek parashtruesja e kërkesës, me të cilën kishin tërhequr vëmendjen e parashtrueses së kërkesës se nëse nuk paguhet

taksa gjyqësore për procedurë ankimore ankesa e saj do të konsiderohet e tërhequr, ajo nuk e kishte bërë këtë. Më tej, parashtruesja ishte udhëzuar se ka mundësi për paraqitjen e kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, brenda periudhës 15 (pesëmbëdhjetë) ditore. Por, ajo nuk kishte ushtruar një kërkesë të tillë.

52. Gjykata konsideron se përfundimet e Kolegjit të Apelit janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të dispozitave përkatëse në lidhje me taksat gjyqësore dhe faktit që parashtruesja e kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore dhe nuk kishte bërë kërkesë për lirim nga kjo pagesë (shih në këtë kontekst dhe rastin e ngjashëm të Gjykatës KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, cituar më lart, paragrafi 41).
53. Gjykata vlerëson se të gjitha çështjet, të cilat ishin të rëndësishme për vendosjen në lidhje me mospagesën e taksës gjyqësore nga parashtruesja e kërkesës, ishin shqyrtuar siç duhet nga Kolegji i Apelit. Të gjitha arsyet materiale dhe ligjore që lidhen me vendimin e kontestuar u analizuan mjaftueshëm. Si rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundim se procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta.
54. Sa i përket kategorisë së dytë të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, përkitazi me parimin e barazisë së armëve, Gjykata rithekson se "barazia e armëve" nënkupton që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme dhe e barabartë për të paraqitur rastin e saj – duke përfshirë provat e saj – në kushte që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme *vis-a-vis* palës tjetër (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Dombo Beheer B.V kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33; si dhe shih rastin e Gjykatës KI31/17, parashtrues: *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 72).
55. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës thekson se nuk iu është dhënë mundësia "*për t'i shpjeguar dhe argumentuar faktet juridike dhe faktike dhe se ajo duhej të ftohej në seancë për rastin e saj*". Megjithatë, Gjykata rikujton se për arsye të mospagesës së taksës, ankesa e parashtrueses së kërkesës ishte konsideruar si e tërhequr. Andaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret parimi i barazisë së armëve, si element qenësor i të drejtës për gjykim të drejtë dhe paanshëm, nuk është shkelur.
56. Në fund, sa i përket kategorisë së tretë të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës rreth vendimit të paarsyetuar, Gjykata fillimisht thekson se sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kunder Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81; si dhe shih rastin e Gjykatës KI87/18, parashtrues: "*IF Skadeforsikring*", Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 45).
57. Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të

drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GJEDNJ-se, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61 si dhe shih rastin e Gjykatës KI87/18, parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, cituar më lart, paragrafi 47).

58. Për sa i përket rastit konkret, duke u mbështetur në praktikën e saj gjyqësore si dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se çështja e taksës gjyqësore është arsyetuar nga Kolegji i Apelit. Për më tepër, Gjykata konsideron se asnjë fakt apo pretendim i paraqitur nga parashtruesja e kërkesës nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtrueses së kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
59. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, Gjykata përsëritë qëndrimin e saj të përgjithshëm se, parimisht, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
60. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

61. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar moszbulimin e identitetit të saj, duke mos dhënë asnjë arsyetim për një kërkesë të tillë.
62. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsye që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. [...]"

63. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar asnjë argument apo dëshmi, me të cilin do të kishte arsyetuar kërkesën e saj për moszbulimin e identitetit. Rrjedhimisht, kjo kërkesë e parashtrueses së kërkesës refuzohet.


PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 39 (2), 32 (6) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për moszbulimin e identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi